



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**

**Komuna e Prishtinës**  
**Opština Priština - Municipality of Prishtina**



Në bazë të nenit 12, paragrafi 12.2, pika d e Ligjit nr. 03/L - 40, për vetëqeverisje lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 28/15, qershor 2008), të dispozitave të nenit 34, paragrafi 34.1, pika d e Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110 - 391, dt. 25.2.2010, Kuvendi i Komunës së Prishtinës, në mbledhjen e mbajtur më 18.05.2016, merr këtë

**V E N D I M**

**PËR FORMIMIN E GRUPIT PUNUES PËR HARTIMIN E PLANIT VJETOR TË PUNËS SË KUVENDIT PËR VITIN 2016**

I. Miratohet Vendimi për formimin e Grupit punues për hartimin e planit vjetor të punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2016.

II. Grupi punues nga pika I e këtij vendimi, është në këtë përbërje:

1. Halim Halimi, kryesues,
2. Shefki Gashi (LDK), anëtar,
3. Laura Zherka (PDK), anëtare,
4. Sylejman Pireva (LVV), anëtar,
5. Rita Begolli (AAK), anëtare,
6. Sami Boroci (AKR), anëtar,
7. Abetare Fazliu (LB), anëtare,
8. Kimet Zeqa (PD), anëtare,
9. Visar Arifaj (PF), anëtar,
10. Nenad Miladinoviq (G.I.S), anëtar,
11. Ardian Olluri, Udhëheqës i Zyrës ligjore, anëtar,
12. Osman Bllaca, auditor i brendshëm, anëtar,
13. Zijadin Gashi, shef i sektorit për punë të kuvendit, anëtar.

III. Detyrë e grupit punues të cekur në pikën II të këtij vendimi, është që në pajtim me kompetencat dhe përgjegjësitë që ka Kuvendi i Komunës, me dispozitat e Ligjit për vetëqeverisje lokale, dispozitat e ligjeve të tjera - pjesën me kompetencë të Komunës, aktet nënligjore dhe Statutin e Komunës, të hartojë planin vjetor të punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2016. Pas hartimit të planit final, grupi punues do ta prezantojë para Kuvendit të Komunës për miratim. Afati për dorëzim të planit vjetor final është dt. 10.06.2016.

IV. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb faqen e Komunës.

**KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS**  
01. nr. 035-121606 , më 19.05. 2016



**KRYESUESI I KUVENDIT**  
Halim Halimi, jur. i dipl.